



REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljena/Prodato Received/Delivery	26. 12. 2023	3	viti god veq.
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBHEK	7670/2023		1/7



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1355/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari - anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1344/2023, të datës 27.10.2023, të parashtruar nga [redacted] dhe ankesën me numër A.nr.1355/2023 të datë 31.10.2023, të parashtruar nga [redacted] të bashkuara sipas Vendimit me numër protokolli 7088/2023 të datës 24.11.2023, në një procedurë të vetme nën shenjen A.nr.1355/2023, kundër Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë/Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1355/2023, e datës 31.10.2023, e parashtruar nga [redacted] ankuesit [redacted]
- II. Anullohet Vendimi Nr.1408 i datës 11.09.2023, i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetëror, Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me shpalljen e kandidateve fitues si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarrë nga faza e verifikimit paraprak deri në publikimin e Njoftimit të datës 12.09.2023, ndërsa, çështja kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.
- III. Obligohet Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarr veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi sikurse është përcaktuar si në pikën II të këtij dispozitivi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

Arsyetim

Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 05.05.2023, në ueb faqen unike të procedurave të konkurrimit, respektivisht në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) ka publikuar Konkursin për grupin "Specialist i Arsimit" me numër reference RN00011608, gjegjësisht pozitën e punës "Inspektor i Arsimit" SIA-Pejë, tri (3) pozita, ku afati i aplikimit ishte nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023. Si rrjedhojë nga shkresat e lëndës rezultoi se në këtë konkurs ka aplikuar edhe kandidati dhe (në tekstin e mëtejme: ankuesit) por që të njëjtit nuk kanë arritur të jenë në mesin e kandidatëve fitues të cilët janë rekomanduar për emërim në Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankuesit, më datë 27.10.2023 dhe 31.10.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se procedura e rekrutimit është përcjell me shkelje të dispozitave ligjore.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sipas kërkesës së anëtarëve të Kolegji të Këshillit, dhe me qëllim të ekonomizimit të procedurës, me datë 24.11.2023 ka nxjerr Vendimin me numër protokollit 7088/2023 me të cilin ka bashkuar procedurën për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.1344/2023 të datës 27.10.2023, të parashtruar nga dhe ankesës me numër A.nr.1355/2023 të datës 31.10.2023 të parashtruar nga duke u regjistruar kështu si një ankesë e vetme nën shenjen e ankesës së fundit me numër A.nr.1355/2023 të datës 31.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptime të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6716/2023 të datës 27.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin nume protokollit 7436 të datës v13.12.2023 të Kryetarit të KPMSHCK për shtyrje të afatit për vendimmarrje, Kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit Rinor Mema të datës 07.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.11.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me Nr.Referencës RN00011608 të datës 05.05.2023 të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme për "Specialistë të Arsimit"; Vendimin me Nr.05/151 të datës 12.07.2023 për emërimin e Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Publike të Kryeministrit të Republikës së Kosovës; Listën e aplikantëve me numër të Referencës: RN00011608; Listën e kandidateve të aprovuar dhe të refuzuar me numër të Referencës: RN00011608; Njoftimin e datës 10.07.2023 të lëshuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB; Njoftimin e datës 19.07.2023 të lëshuar nga Divizioni për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB; Vendimin me Nr.1408/2023 të datës 11.09.2023 për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve përkatësisht për përfundimin e procedurës së konkurrimit me vlerësimet përkatëse; Renditjen përfundimtare të kandidatëve me numër të shpalljes RN00011608 të datës 11.09.2023; Njoftimin e datës 12.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutimit dhe Inspektimit në DMZP-MPB; Ankesën e datës 13.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Vendimin me Nr.1540 të datës 28.09.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialistë të Arsimit; Aplikacionin e ankuesit të datës 31.05.2023 me Nr. Referencës: RN00011608 së bashku me dëshmitë e bashkangjitura si në vijmë: Diplomën për kryerjen e shkollës së mesme të lartë me Nr. Protokollit 126 të datës 24.06.2013 të lëshuar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatën me Nr. Referencës 04/6682 të datës 02.12.2022 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomën me Nr.4073 të datës 16.01.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Licencën e Mësimdhënësit me Nr.1029753 të lëshuar më datë 10.06.2021 me datë të skadimit 10.06.2026 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Certifikatat

për trajnimet e përfunduara 1,2,3,4 dhe 5; Vërtetimin e datës 08.09.2017 të lëshuar nga Koha Ditore; Kontratën e Punës për Mësimdhënës me Nr. Protokolli 2654/132 të datës 07.02.2018; Kontratën e Punës për Mësimdhënës me Nr. Protokolli 3955/196 të datës 01.10.2018 ; Kontratën e Punës për Mësimdhënës me Nr. Protokolli 1122/61 të datës 03.05.2019; Kontratën e Punës për Mësimdhënës me Nr. Protokolli 3592/186 të datës 31.10.2019; Kontratën e Punës për Mësimdhënës me Nr. Protokolli 1903/97 të datës 02.12.2020; Kopjen e letërnjoftimit me Nr.600222 të lëshuar më 15.06.2022; Vlerësimin për Mësimdhënësin të lëshuar nga Drejtori i Shkollës Vërtetimin me numër Nr.1161/58 të datës 30.05.2023 të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Pejës; Pasqyrën e Llogarisë nga Trusti për periudhën kohore nga data 01.08.2002 deri më datën 23.05.2023; Certifikatën mbi dënimet penale me Nr.ser.86048EF59C654E6 të lëshuar më datë 29.05.2023 nga Sektori Qendror i Evidencës Penale të Kosovës; Ankesën me numër protokolli 31.10.2023 të datës 31.10.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit të datës 09.11.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.11.2023 nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Ankesën e datës 13.09.2023 të parashtruar nga ankuesi në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Vendimitt Nr.1538 të datës 28.09.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për Grupin Specialistë i Arsimit; Aplikacionin e ankuesit të datës 26.05.2023 me Nr. Referencës; RN00011608 së bashku më dëshmitë e bashkangjitura si në vijmë: Diplomën me Nr.2744 të datës 26.09.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Diplomën me Nr.1030 të datës 25.03.2023 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"; Certifikatat për trajnimet e përfunduara 1,2,3,4,5 dhe 6; Licencën e Mësimdhënësit me Nr.1031302 të datës së lëshimit më 12.09.2022 me datë të skadimit 12.09.2023 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë; Letrën e referencës të datës 22.01.2021 të lëshuar nga UNICEF Kosovë; Vërtetimin me Nr.prot.1083/23 të datës 17.05.2023 të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe SH.M.U "Zef Serembe" Gllaviçicë; Kopjen e Letërnjoftimit me Nr.033328 të lëshuar më datë 25.01.2019; Vërtetimin me Nr.prot.1084/23 të datës 18.05.2023 të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët "Zef Serembe" Gllaviçicë; Vërtetimin me Nr.prot.1085/23 të datës 19.05.2023 të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe SH.M.U "Zef Serembe" Gllaviçicë; Vërtetimin me Nr.prot.1086/23 të datës 17.05.2023 të lëshuar nga Shkolla Fillore dhe SH.M.U "Zef Serembe" Gllaviçicë; Certifikatën mbi dënimet penale me Nr.ser.B47F1D316B25481 të lëshuar më datë 25.05.2023 nga Sistemin Qendrorë të Evidencës Penale të Kosovës; Pasqyrën e Llogarisë së Trustit Pensional për periudhën kohore 03.08.2018 deri më 23.05.2023; Aplikacionet e kandidateve fitues

se bashku më dëshmitë e bashkangjitura me rastin e aplikimit.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa është e bazuar dhe se lënda ku ankuesit janë palë në procedurë, duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, *sepse*:

Kolegji i Këshillit, në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ndërlidhur me plotësimin e kërkesave të përgjithshme formale të konkursit, nga kandidatët në procedurë, ka analizuar Konkursin me numër të referencës: RN00011608, për grupin "Specialistë të Arsimit", klasa e pozitës, Profesional 1, pozita e punës "Inspektor i Arsimit" në SIA-Pejë, dhe si rrjedhojë ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale, të përcaktuara në konkursin përkatës, kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë me së paku 3 vite të studimeve në fusha: Arsim i Lartë i paspecifikuar;*
- *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës;*

- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitë së lirë të punës me theks të veçantë përvojë pune në mësimdhënie.*

Rrjedhimisht, Kolegji i Këshillit duke ju referuar shkresave të lëndës, gjegjësisht Njoftimit të datës 12.09.2023 të Divizionit për Zhvillimin e Rekrutit dhe Inspektimit në DMZP/MPB, ka gjetur se tre nga kandidatet fitues, me më së shumti pikë, për grupin "Specialistë të Arsimit" pozita "Inspektor i Arsimit në SIA-Pejë", janë: 1. [redacted] me gjithsejtë (78.6) pikë, 2. [redacted] me gjithsejtë (78) pikë, 3. [redacted] me gjithsejtë (77.4) pikë.

Kolegji i Këshillit, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, si dhe në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore analizoi dosjet 3 (tre) kandidateve fitues të cilët kanë mbledhur më se shumti pikë dhe rrjedhimisht janë rekomanduar për emërim në shërbimin civil, dhe si rrjedhojë konstatoi se: 1. Kandidatja [redacted] - me rastin e aplikimit ka dorëzuar Vendimin me Nr.ref.216/1426 të datës 12.02.2021, të MASHT, me të cilin të njëjtës i njihet grada "Magjistër i Metodologjisë së Mësimdhënies së Gjuhës Angleze", Diplomën me Nr.serik.1426 të datës 25.11.2020, përmes të cilës dëshmohet se me 14.10.2020, ka përfunduar studimet Master në Fakultetin Filologjik në drejtimin Gjuhë dhe Letërsi Anglez, në Universitetin e Tetovës si dhe Diplomën me Nr.1774 të datës 04.02.2010, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Fakulteti i Filologjisë përmes të cilës dëshmohet se të njëjtës i njihet kualifikimi universitar "Profesor". Lidhur me përvojën e punë se njëjta ka ofruar si dëshmi Vërtetimin me numër prot:1515/166 të datës 19.05.2023 të lëshuar nga SHFMU "Haxhi Zeka" Zahac, me të cilin vërtetohet se kandidatja ka punuar si mësimdhënëse e gjuhës angleze, nga data 01.09.2009 deri me 31.08.2012; Vërtetimin nr.prot: 01-1134 të datës 23.11.2022 të lëshuar nga SHME "Ali Hadri" në Pejë, me të cilin vërtetohet se ka qenë mësimdhënëse e gjuhës angleze nga data 09.09.2013 e tutje. Kurse sipas shkresave të lëndës të përcjella nga njësia përgjegjëse përkatësisht DMZP-j, rezulton se e njëjta nuk ka ofruar licencë të mësimdhëniesit të kualifikuar sikurse përcaktohet me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës; 2. kandidatja [redacted] me rastin e aplikimit ka dorëzuar Diplomën me numër 946/18 të datës 06.07.2018, të lëshuar nga Kolegji "AAB", me të cilën ka fituar gradën Bachelor i Arteve në Përkujdesje dhe Mirëqenie e Fëmijëve, Vërtetimin nr.159/2023 të datës 17.05.2023, me të cilën vërtetohet se kandidatja ka punuar si Edukatore në IEAP "Gëzimi Ynë" në Istog, nga data 01.09.2003, dhe vazhdon të punoj, ndërsa posedon licencën e mësimdhëniesit me numër 1027990, me afat të vlefshmërisë nga data 27.12.2019 deri me 27.12.2024; 3. Kandidatja [redacted] me rastin e aplikimit ka bashkangjitur diplomën nr.178 të datës 11.05.2017, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit, ka fituar titullim Master i Edukimit, Udhëheqja në Arsim, Diplomën nr.62 të datës 08.06.2011, të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Edukimit, me të cilën dëshmohet se ka marr titull Bachelor i Programit Fillor, Vërtetimin 1796/2023 të datës 17.05.2023, me të cilën vërtetohet se është e punësuar në FMU "Ramiz Sadiku" Pejë, dhe se ka përvojë 28 vjeçare në arsim, kurse sipas shkresave të lëndës të përcjella nga njësia përgjegjëse përkatësisht DMZP-j, rezulton se e njëjta nuk ka ofruar licencë të mësimdhëniesit të kualifikuar sikurse përcaktohet me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës;

Nga analizimi i dosjeve si me lartë të kandidatëve fitues përkatësish sipas dëshmime të dorëzuara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, rezulton se dy prej tyre, respektivisht kandidatja [redacted] dhe [redacted] me rastin e aplikimit nuk kanë dorëzuar Licencë të mësimdhëniesit të kualifikuar ashtu siç ishte kërkuar me konkurs. Ndërsa bazuar në vlerësimin edhe të dëshmime të kandidateve tjerë sipas listës së njoftimit për renditjen përfundimtarë të datës 12.09.2023, Kolegji ka gjetur së në listën e ngushtë janë përfshirë edhe kandidatet që posedojnë licencë të mësimdhëniesit me afat të skaduar të vlefshmërisë ndërsa, disa të tjerë po ashtu nuk kanë ofruar dëshmi lidhur me posedim të

licencës së mësimdhënësit, gjegjësisht sipas provave të lëndës kandidatet
dhe nuk posedojnë licencë të mësimdhënësit, sikurse
përcaktohet me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës;
ndërsa kandidati ka ofruar licencë të mësimdhënësit me numër 10017523 me afat të
skaduar gjegjësisht 13.012.2013 deri me 13.12.2018, kandidati ka ofruar licencën e
mësimdhënësit nr.10022528 me afat të skaduar 27.12.2015 deri me 28.12.2020, kandidat
posedon licencë të mësimdhënësit nr.100018013 me afat të skaduar 13.12.2013 deri 13.12.2018, kandidati
posedon licencën e mësimdhënësit nr.100009203 me afat të skaduar gjegjësisht 26.12.2012
deri me 26.12.2017.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të sqarimit të rrethanave juridike të krijuara si me lartë e që ndërlidhën me
vlefshmërinë e licencave të mësimdhënësve që ju ka skaduar afati e të cilët janë përfshirë në listën e
ngushtë dhe rrjedhimisht në fazat e mëtejme të rekrutimit, ka kërkuar informatë zyrtar nga Departamenti
për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, se mbi cilën bazë juridike janë vlerësuar këto licenca, ndërsa kjo e
fundit, më datë 05.12.2023 ka njoftuar se: *Lidhur me pyetjen tuaj se si kemi bërë vlerësimin e licencave të
mësimdhënësve të cilëve ju ka skaduar afati, a ka ndonjë dokument nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë
dhe Inovacionit si ministri përgjegjës për lëshimin e licencave lidhur me këtë çështje, ju informojmë se Departamenti
për Menaxhimin Zyrtarëve Publik, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të
MASHT-it me nr.14/2023, për sistemin e licencave dhe karrierës i cili përcakton: "Licencat e karrierës së
mësimdhënësve të lëshuara nga vitet 2012-2022, vazhdojnë për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme deri në
realizimin e procesit të brendshme të VPM". Andaj Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka pranuar
të gjitha licencat e mësimdhënësve gjatë verifikimit. Si rrjedhojë, me qëllim të vërtetimit të këtij fakti, më datë
17.11.2023 është kërkuar informatë zyrtare nga përfaqësuesit e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës
nëse Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemin e Licencimit dhe Karrierën në
Mësimdhënie është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ndërsa kjo e fundit të njëjtën
ditë ka konfirmuar se "Udhëzimi Administrativ në fjale nuk gjendet i publikuar në ueb portalin e Gazetës Zyrtare,
gjithashtu të gjitha aktet të cilat vijnë për publikim në portalin e Gazetës Zyrtare zakonisht publikohen brenda ditës".*

Andaj, duke marr parasysh faktin se Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemin e
Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së
Kosovës, Kolegji i Këshillit vlerëson se i njëjti nuk mund të prodhojë pasoja juridike. Për më tepër, edhe
sikur të ishte i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, i njëjti për shkak të mënyrës se si
është nxjerrjes (gjatë fazës së zhvillimit të procedurës së rekrutimit) nuk do të mund të aplikohet në
rrethanat e rastit konkret, ngase do të paraqiste situatë diskriminuese në raport me gjithë kandidatët tjerë
të cilët kanë poseduar licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, me afat të skaduar, dhe nuk kanë aplikuar
apo kanë aplikuar dhe ju ka refuzuar aplikacioni, për shkak të kriterit të konkursit, ngase në shpallje të
konkursit decidivisht është kërkuar "Licenca e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit
Nr. 04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës".

Prandaj, duke marr për bazë dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 për
Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (e aplikueshme në kohën e zhvillimit
të procedurës përkatëse të rekrutimit), ku përcaktohet se: "Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse
kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve
të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak.
3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim.
Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin në fazën e
mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë", dhe rrjedhimisht, duke qenë se tani më është vërtetuar se janë
përfshirë në listë të ngushtë, dhe për më tepër janë shpallur fitues edhe kandidatë të cilët nuk i kanë
plotësuar kriteret formale, sikurse është rasti me kandidatet dhe të cilët nuk

posedojnë një licencë të mësimdhënësit, Kolegji i Këshillit konstaton se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse, ka vepruar në kundërshtim me nenin 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe si rrjedhojë në kundërshtim me dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke mos respektuar kështu kriterin formal të përcaktuar në konkurs nga vetë organi përkatës që ka zhvilluar procedurën e rekrutimit, dhe për pasojë ka vepruar në kundërshtim edhe me nenin 34 të Ligjit Nr.04/L-032 për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, nisur nga qëndrimet e dhëna si me lartë rezultojnë se aktet e goditur me ankesë, gjegjësisht e Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, lidhur me kandidatet fitues për grupin "*Specialit i Arsimit*" me numër reference RN00011608, pozita e punës "*Inspektor i Arsimit*" në SIA-Pejë, janë nxjerr përmes shkeljes së dispozitave procedurale dhe zbatimit të gabuar të ligjit material, ngase njësi përgjegjëse ka dështuar t'i zbatoj dispozitat që i përkasin fazës së verifikimit paraprak të dokumenteve, dhe gabimisht ka zbatuar ligjin material kur ka vendosur t'i përfshij në listë të ngushtë edhe kandidatët të cilët nuk kanë poseduar Licencë të mësimdhënësit të kualifikuar, duke vepruar kështu në kundërshtim me kriteret formale të konkursit dhe si rrjedhojë dispozitat e nenit 34 paragrafi 6 nën paragrafi 6.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, dhe dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ashtu që si i tillë ky Vendim, respektivisht Njoftim është i paligjshme në kuptim të nënti 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se procedura e pranimit në shërbimin civil sipas Konkursit me numër reference RN00011608 për grupin "*Specialit i Arsimit*", pozita e punës "*Inspektor i Arsimit*" në SIA-Pejë, nga faza e verifikimit paraprak e tutje është zhvilluar në kundërshtim me parimet e pranimit të zyrtareve publikë, siç parashihet me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcaktohet se: "*1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Nëpunësit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuar në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore*", kështu që si rezultat i shkeljeve të evidentuara si me lartë, u vendos që të aprovohet ankesa si e bazuar, dhe të anulohet Vendimi me Nr.1408 i datës 11.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetëror, Njoftimi i datës 12.09.2023 i Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, lidhur me shpalljen e kandidateve fitues si dhe çdo veprim tjetër administrativ i ndërmarrë nga faza e verifikimit paraprak deri në publikimin e Njoftimit të datës 12.09.2023, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe ri-vendosje tek Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si njësi përgjegjëse, obligohet që në ri-procedurë të vepronte sipas pikëpamjeve juridike të këtij vendimi, dhe se vetëm pas konstatimit se kandidatët, duke përfshi këtu edhe ankueset, i plotësojnë kriteret formale të konkursit, të përgatis listën e ngushtë dhe të procedoj me fazat tjera të rekrutimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë

(30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1355/2023

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Zyrtar e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankueseve: [redacted] dhe [redacted]
- Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë - MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.